


-D.T.I.M.P
23.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. 314/ 1155 Akti

Datë 16.06.2021

“NJOFTIM ME SHPALLJE”

Drejtuar: Bashkise Maliq

Per te padituren : Blerina Hoxha, me adrese Blloku nr. 2 Maliq

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë u gjykua çështja civile me nr. 314/155 akti, datë regj. 27.07.2020, që i'u përket palëve:

PADITËS : Edison Qarri, i biri i Rrapi dhe i Olimbi, i datl. 26.06.1983, lindur dhe banues ne Mifol, Njesia Administrative Novosele Bashkia Vore, I identifikuar nga gjykata nepermjet leternjoftimit elektronik me nr. personal...I30626157K, perfaqesuar nga av. Gentian Leka, i pajisur me prokure te posacme me nr. 946 re.p dhe kol.348 date 08.04.2021.

E PADITUR : Blerina Hoxha, e bija e Asllan dhe e Teuta, e datl. 19.09.1990, lindur ne Panarit, Korce dhe banuese ne Maliq, Bashkia Maliq, ne mungese,

OBJEKTI : Kerkohet ndryshimi i pergjegjesise prinderore mbi femijen e mitur lindur jashte martesese Anxhelo Qarri, i datl. 06.12.2015, i biri i Edison dhe i Blerina, duke iu lene ky femije nen pergjegjesine prinderore vetem paditesit, si dhe percaktimin e qarte nga ana e Gjykares se me cilin prind do te banoje femija.

B. Ligjore : Nenet 227 paragrafi i 2 dhe i 3 i Kodit te Familjes.

Ne séance gjyqesore te dates 30.04.2021 gjykata Vendosi:

Pranimin e kerkese padise.

-Ndryshimin e ushtrimit te pergjegjesise prinderore per femijen e mitur Anxhelo Qarri i datl. 06.12.2015, nga e paditura (nena) Blerina Hoxha, duke i kaluar e drejta e ushtrimit te pergjegjesise prinderore ndaj femijes (e drejta e mbajtjes se ketij femije) tek paditesi (ati) Edison Qarri.

Pr. 64 Prot

Dt. 24.06.2021

-Te drejten e takimit te te paditures Blerina Hoxha me femijen e mitur Anxhelo Qarri i datl. 06.12.2015, nje here ne muaj, te premten e katert te cdo muaji, duke filluar nga ora 10.00 deri ditën e djele ne oren 16.00, si dhe te drejten e takimeve te nenes me femijen gjate pushimeve dimerore, nga data nje janar deri me daten pese janar dhe per pushimet verore, nga data nje gusht deri me pesembedhjet gusht te cdo viti.

-Shpenzimet gjyqesore te perbera nga taksa mbi aktet ne shumen 3,000 (tremije) leke, si dhe shpenzimet per punen e psikologes ne masen 30, 000 (tridhjete mije) leke, dhe shpenzimet per avokat te parapaguar nga paditesi ne shumen 50,000 (pesedhjete mije) leke, sic jane bere.

-Urdherohet kryesekretaria gjyqesore qe nje kopje te ketij vendimi, pasi te marre forme te prere ta depozitoje prane Zyres se Gjendjes Civile Bashkia Maliq, per t'u bere ndryshimet e mesiperme me aktet e gjendjes civile te ndergjyqsave dhe femijes se mitur.

-Ky vendim pasi te marre forme te prere, perben titull ekzekutiv, eshte i ekzekutueshem, per kete qellim leshohet urdheri i ekzekutimit, i cili gjendet i pasqyruar ne dispozitivin e vendimit.

-Kunder vendimit mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Korçë , brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga dita e komunikimit te vendimit te arsyetuar.

-U shpall ne Korçë me date 30.04.2021 ora 11.30.

Kjo shpallje do të qëndroje e afishuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si gjykata ku gjykohet mosmarrëveshja, një kopje pranë vendbanimit Tuaj zyrtar, nje kopje prane Bashkise Maliq, si dhe në faqen zyrtare të gjykatës minimalisht 20 (njëzet ditë) nga data e afishimit.

Shpallja do t'iu dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave duhet të përcillet në gjykatë, menjëherë pas afishimit.

GJYQATAR
Maksim Qirjazi

Shpallja u afishua sot në datë _____.

Per Bashkine Maliq
(emër, mbiemër, firmë)